



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 49/16

Prishtinë, më 24.03.2016, ora 15:30

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Safete Hadergjona, Jelena Bontic, Ilir Deda, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-033 si dhe ligjin nr. 04/L-115 dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-033 si dhe ligjin nr. 04/L-115 dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit

3. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Klllokotit për vitin 2016

Kryetari – theksoi se projektligji dhe amendamenti i komisionit funksional nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligji Nr.05/L-033 si dhe Ligjin Nr.04/L-115, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamenti i propozuar nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligji Nr.05/L-033 si dhe Ligjin Nr.04/L-115, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

3. Të ndryshme

Kryetari – njoftoi anëtarët se Kryesia e Kuvendit e ka ngarkuar Komisionit, që të shqyrtojë kërkesën e pesë deputetëve të Kuvendit: Blerta Deliu, Besa Gaxherri, Naser Osmani, Adem Hodza dhe Haxhi Shala, për kompensimin e dëmeve materiale për dëmtimin e veturave të tyre në parkingun e Kuvendit të Kosovës, të ndodhur në protestën e datë 17 nëntor 2015. Unë propozoj që ti rekomandojmë Kryesisë që miratojë kërkesën për kompensimin e dëmeve, por që shuma maksimale e kompensimit të jetë 1,000 euro.

Në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

- I. I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit, të miratojë kërkesën e pesë deputetëve të Kuvendit: Blerta Deliu, Besa Gaxherri, Naser Osmani, Adem Hodza dhe Haxhi Shala, për kompensimin e dëmeve materiale për dëmtimin e veturave të tyre në parkingun e Kuvendit të Kosovës, të ndodhur në protestën e datë 17 nëntor 2015.
- II. Kompensimi monetar të bëhet nga Buxheti i Kuvendit të Kosovës, në bazë të faturave të prezantuara dhe shuma maksimale e kompensimit të jetë 1,000 (një mijë) euro.

Mbledhja përfundoi në ora 15:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani